



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

- DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE RAJONALE -

ANALIZA PËR FUNKSIONIMIN E ZONAVE EKONOMIKE NË KOSOVË



Dhjetor, 2019

Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, i hartuar me qëllim që të shërbej si burim informacioni në procesin e hartimit dhe zhvillimit të programeve të vazhdueshme për përkrahje të zonave ekonomike në Kosovë, nga vet MZHR dhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës.

DOKUMENTI U PUNA NGA:

Grupi Punues

Kryesuese - Vjendita Avdiu Musliu, Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

Anëtar – Ymer Rraci- Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim dhe Koordinim të Nismave Rajonale

Anëtare - Vlora Fetoshi, Zyrtare për Zhvillim Socio – Ekonomik

Anëtar – Sanel Muriç – Zyrtar për Financa

Anëtar – Xhevat Sefaj –Zyrtar për Integritet Evropian

Dokumenti u hartua nën mbikëqyrjen e z. Blerim Hasani, Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale.

Copyright. 2019 – Ministria e Zhvillimit Rajonal

Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë

Tel. +381 (0) 38 64 516 / <https://mzhr.rks-gov.net/language/sq/>

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave _____	4
I. Hyrje _____	5
II. Baza ligjore për themelimin e Zonave Ekonomike dhe kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik _____	6
III. Zonat Ekonomike të themeluara _____	7
3.1 Lista e përgjithshme e zonave ekonomike të themeluara _____	7
3.2 Zonat ekonomike në proces të funksionalizimit _____	7
3.2.1 Parku Industrial në Mitrovicë _____	8
3.2.2 Parku Industrial në Lipjan _____	9
3.2.3 Parku Industrial në Viti _____	9
3.2.4 Parku Industrial në Vushtri _____	9
3.2.5 Zona Agro Industriale në Suharekë _____	10
3.3 Zonat Ekonomike të funksionalizuara _____	10
3.3.1 Parku Industrial Drenas _____	10
3.3.2 Raporti ndërmjet Komunës së Drenasit dhe Zonës Ekonomike _____	12
3.3.3 Realizimi i vizitave nga MZHR në Zonën Ekonomike _____	12
3.3.4 Ndërlidhja e veprimtarive biznesore me Programet e MZHR-së _____	13
3.4.1 Parku i biznesit Mitrovicë _____	14
3.4.2 Raporti ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Zonës Ekonomike _____	15
3.4.3 Realizimi i vizitave nga MZHR në Zonën Ekonomike _____	16
3.4.4 Ndërlidhja e veprimtarive biznesore e Zonës me Programet e MZHR-së _____	17
3.5.1 Parku Teknologjik Shtime _____	17
3.5.2 Raporti mes Komunës Shtime dhe Zonës Ekonomike _____	18
3.5.3 Realizimi i vizitave nga MZHR në Zonën Ekonomike _____	19
3.5.4 Ndërlidhja e veprimtarive biznesore me Programet e MZHR-së _____	20
3.6.1 Zona Industriale në Shirokë të Suharekës _____	20
3.6.2 Raporti mes Komunës Suharekë dhe Zonës Ekonomike _____	21
3.6.3 Realizimi i vizitave nga MZHR në Zonën Ekonomike _____	22
3.6.4 Ndërlidhja e veprimtarive biznesore me Programet e MZHR-së _____	23
IV. Përmbajtja e pyetësorëve _____	23
V. Përfundime dhe Rekomandime _____	25
VI. Burimet e Informacionit _____	27

Lista e shkurtesave:

MZHR - Ministria e Zhvillimit Rajonal

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

KIESA - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

ZE - Zonat Ekonomike

RZH- Rajonet Zhvillimore

AZHR Veri - Agjencinë për Zhvillim Rajonal Veri

AZHR Qendër - Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër

AZHR Jug - Agjencinë për Zhvillim Rajonal Jug

AZHR Lindje - Agjencinë për Zhvillim Rajonal Lindje

AZHR Perëndim - Agjencinë për Zhvillim Rajonal Jug

PZHRB - Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

DPASER - Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio Ekonomike Rajonale

I. Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në shtojcën 21 të Rregullores (QRK) 16/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ka në mandat që në koordinim me MTI-në të përkrahë zhvillimin e Zonave Ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Konform mandatin që ka të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, MZHR në bazë të vendimit nr: 929, të datës 01 Tetor 2019 ka formuar Grupin Punues për hartimin e Analizës për Funksionimin e Zonave Ekonomike në Kosovë. Përmes këtij dokumenti, MZHR synon të pasqyrojë gjendjen aktuale të funksionimit të zonave ekonomike, si dhe të identifikojë politika dhe programe për zhvillim në vitet në vijim, që ndërlidhen me përkrahje të bizneseve që funksionojnë në kuadër të zonave. Me qëllim të përmbushjes së mandatin të sajë dhe realizimit të Planit të Punës për vitin 2019, në muajin Maj dhe Qershor, MZHR dhe MTI realizuan dy (2) takime të përbashkëta konsultative dhe përgatitore për hartimin e këtij dokumenti. Njëra prej përfundimeve të këtyre takimeve, ishte dhe dakordimi për realizimin e vizitave të përbashkëta tek bizneset që operojnë në kuadër të zonave ekonomike. Gjatë muajit Gusht 2019, MZHR në koordinim me MTI-në kanë përgatitur planin për realizimin e vizitave në Zona Ekonomike ku operojnë biznese funksionale. Zonat ekonomike të vendosura në plan ishin: Parku i Biznesit Drenas, Parku i Biznesit në Mitrovicë, Parku Teknologjik në Shtime, si dhe Zona Industriale në Shirokë të Suharekës. Qëllimi i realizimit të këtyre vizitave nga MZHR, ishte të identifikojë nevojat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen bizneset në kuadër të zonave ekonomike, si dhe konform mandatin që ka të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, të identifikojë dhe zhvillojë politika dhe programe për përkrahje të këtyre zonave përmes financimit të projekteve/granteve për biznese. Vizitat në zona ekonomike, u realizuan nga datë 02 deri 05 Shtator 2019 dhe u plotësuan rreth 45 pyetësorë me pyetje dhe përgjigje që ndërlidhen me ambientin e të bërit biznes në kuadër të zonave ekonomike. Pyetësorët u plotësuan me përfaqësues të bizneseve që funksiononin në kuadër të zonave, ku në përmbajtje të këtij dokumenti paraqiten rezultatet e dhënies së përgjigjeve nga bizneset, në pyetjet e përgatitura nga DPASR. Me qëllim të ndërlidhjes së burimeve të informacionit dhe forcimit të fakteve në dispozicion për hartimin e kësaj analize, Grupi Punues ka përgatitur dhe realizuar Planin e vizitave në komunat: Drenas, Shtime, Suharekë dhe Mitrovicë Jugore. Takimet konsultative me Komuna janë realizuar gjatë muajit Tetor 2019 në koordinim me Drejtoritë për Zhvillim Ekonomik, Qendrat e Bizneseve si dhe drejtoritë tjera relevante në kuadër të Komunave përkatëse.

Realizimi i takimeve konsultative me komunat, kishte për qëllim trajtimin e rolit dhe rëndësisë së komunikimit/mbështetjes së komunave kundrejt bizneseve që operojnë në zona ekonomike. Nga takimet dhe konsultimet e realizuara, mund të konsiderohet se komunat kanë një rol të rëndësishëm për të mbështetur zonat ekonomike, konkretisht bizneset, ofrimin të kushteve infrastrukturore, qasjen në shërbimet publike (ujë, kanalizim, mbeturina), lehtësirat në taksa, prona komunale, alokimin e kërkesave, ofrimin e mbështetjes dhe bashkëpunimit.

II. Baza ligjore për themelimin e Zonave Ekonomike dhe kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik (Ligji Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike)

Trajtimi i funksionimit të zonave ekonomike, nuk mund të kalohet pa shtjelluar gjenezën e themelimit të tyre. Themelimi i Zonave Ekonomike, Zonave të lira ekonomike është i rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike¹, i cili ligj krijon bazën për hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike, vendndodhjen e zonave ekonomike, mënyrën e shfrytëzimit të zonave ekonomike, promovimin e zonave ekonomike dhe formimin e këshillit kombëtar për zonat ekonomike.

Themelimi i Zonave Ekonomike realizohet me vendim të Qeverisë së Kosovës. Gjithashtu ZE-të mund të themelohen edhe me vendim nga vet Komunitet brenda territorit dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Me marrjen e pëlqimit, MTI jep miratimin për themelimin e zonës ekonomike nëse propozimi për themelimin e zonës ekonomike është në pajtim me planin nacional për zonat ekonomike dhe nëse studimi i fizibilitetit arsyeton themelimin e zonës ekonomike. MTI, me akt nënligjor e përcakton procedurën e paraqitjes së kërkesës për marrjen e pëlqimit dhe procedimit të sajë. Qëllimi i krijimit të Zonave Ekonomike është nxitja dhe inkurajimi i investimeve në Kosovë për t'ju ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste, zhvillim të përgjithshëm ekonomik, posaçërisht sektorit privat, hapjen e vendeve të reja të punës, përqendrimi dhe promovimi i bizneseve në një vend të caktuar, zgjerimi i bashkëpunimit mes bizneseve, krijimi i kushteve për qasje më të lehtë në transport, furnizim me energji, ujë dhe shërbime në mbështetje të bizneseve, rritjen e konkurrencës mes biznesit vendor dhe ndërkombëtar, qarkullimin e mallrave dhe kapitalit, si dhe zhvillimin rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kosovar me atë ndërkombëtar.

Në zonat ekonomike mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk e cenon rendin publik, mbrojtën e shëndetit publik, mjedisin, florën, faunën dhe pasuritë kombëtare të Kosovës dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi. Shoqëritë e huaja tregtare mund të ushtrojnë veprimtarinë në zonat ekonomike në bazë të një kontrate me themeluesin si përfitues i parcelës, në qoftë se ato janë të regjistruara në Republikën e Kosovës për ushtrimin e veprimtarisë e cila do të kryhet në zonën ekonomike dhe do të plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj. Kushtet dhe lehtësirat për biznese për të zhvilluar veprimtarinë e tyre janë të rregulluara me akte nënligjore dhe zhvillohen me synim të tërheqjes së investimeve të reja në kuadër të Zonave Ekonomike. Përmes Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike janë të definuara edhe kushtet për themelimin dhe funksionimin e Inkubatorëve të Biznesit siç e kemi të themeluar në Parkun e Biznesit në Drenas të cilët shërbejnë shumë duke krijuar lehtësira për bizneset e reja, me një staf menaxhues dhe mbështetës i cili ka për qëllim sigurimin e hapësirave fizike për punë, si dhe lehtëson dhe mundëson mbështetje në shërbimet teknike të biznesit. Inkubatorët e biznesit përkujdesen për ndërmarrjet fillestare për t'ju ndihmuar që të mbijetojnë në periudhën e ndjeshme fillestare kur ato janë në fazat e para të zhvillimit të tyre.

Zhvillimi i Zonave Ekonomike realizohet në kuadër të Planit Kombëtar të Zhvillimit të Zonave Ekonomike dhe çdo plan tjetër nga Qeveria dhe Komunitet duhet të harmonizojë planet e tyre

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8654> - Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 6/12 Mars 2013, Prishtinë - Ligji Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike

hapësinore me Planin Kombëtar të Zhvillimit të Zonave Ekonomike. Këshilli Kombëtar për Zona Ekonomike është organ këshillues rreth zhvillimit të politikave të Zonave Ekonomike i cili emërohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si dhe përbëhet nga përfaqësues të: MTI-së, MF-së, MZHE-së, MBPZHR-së, MAPL-së , një (1) përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe tre (3) përfaqësues të asociacioneve të bizneseve. Mënyra e punës, fushëveprimi dhe organizimi i Këshillit Kombëtar është i rregulluar sipas Rregullores ²Nr.01/2013 e cila rregullore është e miratuar në bazë të ligjit nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, Neni (20), Paragrafi (8).

Rol të rëndësishëm në mbështetjen e Zonave të veçanta Ekonomike ka agjencia shtetërore e Kosovës KIESA³ e cila përkrah dhe promovon Zonat Ekonomike duke: zhvilluar diskutime nëpër konferenca dhe takime, bashkëpunon dhe koordinohet me Komuna për vendosjen e investitorëve të huaj dhe vendor, pranon, shqyrton dhe vlerëson aplikacionet e ofruara nga zhvilluesit e ZE, ofron informata për infrastrukturën fizike në kuadër të ZE të legalizuara, shqyrton ankesat e bizneseve si dhe njofton investitorët potencial për legjislacionin primar dhe sekondar të Zonave Ekonomike.

III. Zonat Ekonomike të themeluara

Në këtë analizë trajtohen nëntë (9) Zona Ekonomike të themeluara në tërë territorin e Kosovës(9)⁴, katër (4) nga këto zona ekonomike janë funksionale me biznese që operojnë me veprimtaritë e tyre biznesore. Ndërsa, zonat tjera janë në proces e sipër të procedurave administrative të vendosjes së bizneseve, finalizimit të infrastrukturës fizike dhe operimit të tyre.

Disa prej tyre ende nuk janë funksionalizuar dhe kanë një numër shumë të vogël të bizneseve të vendosura apo janë në fazë të nënshkrimit të kontratave, ku bizneset ende janë të pa'sistemuara. Në kuadër të zonave ekonomike bëhet përqendrimi i bizneseve në një vend të caktuar dhe promovimi me i lehtë i tyre, zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet bizneseve, qasje më e lehtë e bizneseve në transport, energji elektrike, ujë dhe shërbime tjera. Krijimi i zonave të lira ekonomike në Kosovë në vazhdimësi konsiderohet si një përparësi për tërheqjen e investimeve ndërkombëtare. Në vijim gjeni të listuara gjitha zonat ekonomike të themeluara sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa përmes kësaj analize do të shtjellojmë detajisht funksionim e (4) katër zonave: (Parku biznesit Drenas, Parku i Biznesit Mitrovicë, Parku Teknologjik Shtime dhe Zona Industriale në Shirokë të Suharekës) të cilat janë funksionale për sa i përket numrit të bizneseve që operojnë në to. Përzgjedhja e këtyre katër Zonave për trajtim është realizuar bazuar në mundësitë dhe kapacitetet financiare të MZHR-së për përkrahje të bizneseve përmes dhënies së granteve që kanë për synim zgjerimin e kapaciteteve të tyre, gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe zëvendësimin e importit. Zonat tjera të cekura më poshtë do të shtjellohen në terma të përgjithshëm sipas të dhënave të pranuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, se këto Zona ende nuk janë funksionalizuar me aktivitete biznesore dhe janë në faza të konsolidimit të infrastrukturës fizike, prandaj ende nuk mund të hyjnë në kuadrin e planifikimit të përkrahjes nga MZHR.

² <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/8B7B0232-0CD8-463F-AEF3-A71ECCDB69A9.pdf> - Rregullore nr.01/2013 për punën e Këshillit për Zonat Ekonomike

³ <https://kiesa.rks-gov.net/> - Faqja zyrtare e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë

⁴ <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,65>

3.1 Lista e përgjithshme e zonave ekonomike të themeluara

Nga burimet e informacionet të shfrytëzuara për hartimin e kësaj analize dhe të dhënave të ofruara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, konstatojmë së aktualisht i kemi nëntë (9) zona ekonomike në Kosovë.

Katër (4) zona ekonomike janë kompletuar me gjithë infrastrukturën dhe në to ka biznese që ushtrojnë aktivitete biznesore. Ndërsa, katër (4) zonat tjera janë në proces të funksionalizimit sa i përket kompletimit të infrastrukturës dhe ofrimit të ambientit për të bërë biznes.

Zonat ekonomike të cilat janë të themeluara në kohën kur ky dokument po hartohet nga MZHR, janë:

1. Parku i Biznesit Drenas
2. Parku i Biznesit Mitrovicë
3. Parku Teknologjik në Shtime
4. Parku Industrial në Mitrovicë
5. Zona Agro-Industriale në Suharekë
6. Parku Industrial në Lipjan
7. Zona Industriale në Shirokë të Suharekë
8. Parku Industrial në Budrikë të Vitisë
9. Parku Industrial në Lumadh Vushtrri

3.2 Zonat ekonomike në proces të funksionalizimit

Zonat ekonomike të themeluara, mirëpo që ende janë në proces të kompletimit të infrastrukturës fizike dhe funksionalizimit me biznese, janë si vijon:

- Parku Industrial në Mitrovicë
- Parku Industrial në Lipjan
- Parku Industrial në Viti
- Parku Industrial në Lumadh Vushtrri
- Zona Agro-Industriale në Suharekë

Marrë parasysh se këto zona, janë ende në proces të funksionalizimit dhe sigurimit të kushteve për të bërë biznes, nuk hyjnë në zonat potenciale për përkrahje nga MZHR në vitin 2020.

3.2.1 Parku Industrial në Komunën e Mitrovicës

Ky park gjendet në fshatin "Frashër të Vogël" dhe është krijuar në vitin 2014⁵. Ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 48 (ha). Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), së bashku me Komunën e Mitrovicës në vitin 2014 i filluan investimet e para, mirëpo në mungesë të mjeteve buxhetore ende nuk është arritur finalizimi i ndërtimit të infrastrukturës fizike, megjithatë ka filluar nënshkrimi i kontratave për vendosjen e disa bizneseve, duke përfshirë veprimtari të ndryshme si: prodhimin e mobileve, prodhimin e ngjyrave dhe ngjitesve, prodhimin e dyerve nga druri,

⁵ Të dhënat e pranuar nga MTI/datë 16 Dhjetor 2019

përpunimin e mbetjeve medicinale etj. Deri me tani në këtë Park operimin me veprimtarinë biznesore e ka filluar vetëm një biznes sipas të dhënave të konfirmuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

3.2.2 Parku Industrial në Lipjan

Parku Industrial në Lipjan është krijuar në vitin 2016⁶ me një sipërfaqe të përgjithshme prej 56 (ha). Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës (KIESA) është duke investuar në ndërtimin e infrastrukturës fizike, me qëllim të vendosjes së bizneseve vendore dhe të huaja. Zhvillimi i zonës është fazën e dytë të realizimit të projektit, ku kryesisht është duke u punuar në rregullimin e platesë së dytë, me gjërmim dhe mbushje, ndërsa në platenë e parë është duke u punuar në finalizimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, infrastrukturës rrugore dhe ndriçimit. Gjithashtu në këtë Park pritet të ndërtohet edhe rruga lidhëse që do të lidhë Zonën Industriale në Lipjan me rrugën lokale Lipjan – Airoport. Kjo Zonë dhe hapsirat infrastrukturore fizike pritet të jenë të gatshme dhe të jepen në shfrytëzim për bizneset në vitin 2021.

3.2.3 Parku Industrial në Viti

Ky Park është themeluar në vitin 2017, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 15.50⁷ (ha). Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovës (KIESA) është duke investuar në ndërtimin e infrastrukturës fizike me qëllim të vendosjes së bizneseve. Ky park konsiderohet të jetë një vend ideal për investime të huaja për rajonin e Vitisë dhe Gjilanit dhe investimet që janë duke u bërë do të afrojnë kushte ideale për ushtrimin e veprimtarisë biznesore. Në këtë fazë është duke u punuar në infrastrukturën fizike si: kanalizimi fekal dhe atmosferik, ndriçim, elektrikë dhe infrastrukturë rrugore. Parku Industrial në Viti dhe hapësirat infrastrukturore fizike pritet të jenë të gatshme dhe të jepen në shfrytëzim në gjysmën e dytë të vitit 2020.

3.2.4 Parku Industrial në Lumadh Vushtrri

Parku Industrial në Vushtrri është themeluar në vitin 2018. Ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 14.86⁸ (ha). Ky park ka një pozitë të favorshme gjeografike meqenëse gjendet afër magjistrales Prishtinë – Mitrovicë dhe kjo ju mundëson bizneseve një qasje më të favorshme në gjithë territorin e vendit si dhe lidhje më të shpejta rrugore me vendet e rajonit. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) është duke investuar në ndërtimin e infrastrukturës fizike. Aktualisht është duke u punuar në rregullimin e infrastrukturës fizike duke përfshirë: kanalizimin, ujësjellësin dhe rrugët brenda vet zonës. Dhënia në shfrytëzim e hapësirave me infrastrukturë të gatshme fizike për bizneset nuk ka të përcaktuar një periudhë të saktë, mirëpo gjithçka pritet të jetë e gatshme me rastin e përfundimit dhe përmbylljes së punimeve.

⁶ Të dhënat e pranuar nga MTI/datë 16 Dhjetor 2019

⁷ Të dhënat e pranuar nga MTI/datë 16 Dhjetor 2019

⁸ Të dhënat e pranuar nga MTI/datë 16 Dhjetor 2019

3.2.5 Zona Agro-Industriale në Suharekë

Sipas të dhënave të publikuara nga KIESA, Zona Agro-Industriale, është krijuar në vitin 2015 me sipërfaqe prej 28 ha. Kanë filluar investimet e para në këtë zonë, respektivisht në rrethoj, rrymë dhe ujë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), së bashku me komunën në vitin 2015 kanë filluar investimet në këtë zonë, mirëpo në mungesë të mjeteve buxhetore ende nuk është arritur finalizimi i ndërtimit të infrastrukturës fizike për të u vendosur bizneset, megjithatë ka filluar vendosja e bizneseve në këtë zone ekonomike.

3.3 Zonat ekonomike të funksionalizuara

Në kuadër të numrit të përgjithshëm të zonave ekonomike, katër (4) zona janë të funksionalizuara me të gjitha parakushtet për ofrimin e hapësirës për të bërë biznes dhe në kuadër të cilave operojnë biznese me veprimtari të ndryshme biznesore.

Zonat ekonomike të funksionalizuara dhe në të cilat funksionojnë një numër i konsiderueshëm i bizneseve, janë:

- Parku i biznesit në Drenas
- Parku i Biznesit në Mitrovicë
- Parku Teknologjik në Shtime
- Zona Industriale në Shirokë-Suharekë.

Marrë parasysh mandatin e MZHR-së dhe programet që i realizon çdo vit (Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar – Përkrahje të bizneseve), këto zona janë trajtuar hollësisht nga Grupi Punues dhe Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale.

Në vijim, pasqyrohet trajtimi dhe rezultatet e dala për secilën zonë ekonomike.

3.3.1 Parku i biznesit në Drenas

Parku i Biznesit në Drenas, është shpall zonë ekonomike me Vendim, Nr 06/140⁹ të Qeverisë së Kosovës me datë 18.08.2010. Parku shtrihet në kilometrin e 16-të përgjatë magjistrales Prishtinë – Pejë, në fshatin Koreticë e Epërme. Nga vizitat e realizuara, është konstatuar se parku ofron një vend me infrastrukturë fizike mjaft të mirë dhe shërbime kualitative. Ka një sipërfaqe prej 24 ha. të ndarë në 56 njësi të madhësive të ndryshme: 43 parcela me sipërfaqe deri në 3000 m², 7 parcela me sipërfaqe prej 3000 deri në 6000 m² dhe 6 parcela me sipërfaqe mbi 6000m². Kjo sipërfaqe e tokës është ndarë nga Komuna e Drenasit dhe infrastruktura është financuar nga buxheti e Kosovës. Çdo ngastër ka qasje direkte në rrugët kryesore të Parkut si dhe ka kyçje individuale në rrjetin kryesor të parkut me kanalizim, ujë, telefoni, internet, etj. Momentalisht janë të vendosura 41 biznese me veprimtari të ndryshme biznesore, duke filluar nga: prodhimet farmaceutike, prodhimin e liftave, metalpunues, sektori i drurit, paneleve të ndryshëm e deri tek riciklimi i plastikës. Nuk ka hapësira të lira për vendosje të bizneseve të reja në këtë park. Specifike e këtij parku është themelimi dhe ndërtimi i Inkubatorit të Biznesit i cili fatkeqësisht nuk është funksional dhe kjo konsiderohet një e metë e madhe dhe sfidë në

⁹ Komentet e pranuar nga Komuna Drenas/datë 13 Nëntor 2019

të ardhmen për tu funksionalizuar sa më shpejtë në mënyrë që të shërbeje me efikasitet në zhvillimin, funksionalizimin dhe stimulimin e bizneseve të reja.

Bazuar në të dhënat zyrtare të marra nga Komuna Drenas nga 41 biznese që operojnë brenda zonës ekonomike, veprimtaria më e dalluar në këtë Zonë duke u bazuar është prodhimi me 37 profile të ndryshme biznese, duke vijua me shërbimet dhe tregtinë ku në total veprimtaritë e tilla realizohen nga 4 biznese. Numrin¹⁰ më të madh të bizneseve në veprimtarinë e prodhimit e ka sektori i prodhimit të dyerve, dritareve me (12) dymbëdhjetë biznese, duke vijua me sektorin e dytë me radhë të prodhimit të letres dhe plastikës me (6) biznese dhe sektori i tretë me radhë është sektori i prodhimit të metaleve, hekurit, çelikut, llaçeve etj me (4) biznese. Më detajisht sektorët më të zhvilluar mund ti gjeni të shtjelluara në Tab.1.1, ndërsa sa i përket numrit të punësuarve në bazë të dhënave të konfirmuara nga Komuna Drenas, nga 41 biznese që operojnë në këtë park janë të punësuar gjithsejtë 388, ku nga ky numri përgjithshëm 281 janë të gjinisë mashkullore dhe 107 janë të gjinisë femërore.

Tab. 1.1 Bizneset, veprimtaria dhe profilet në Parkun e Biznesit Drenas

Veprimtaria	Sektorët	Numri i bizneseve
Prodhim	Prodhim I profilit dyer, dritare, pvc, shkalla, ashensorë	12
	Prodhime ushqimore	3
	Prodhim letër , tiketa reklamuese, thasë mbeturinash, paketim letre dhe plastike	6
	Prodhim druri	2
	Prodhim llamarinë, çelik, hekur, metal, llaqe, folie, ngjitës	4
	Prodhues tekstili	2
	Prodhime farmaceutike	1
	Prodhim, profili i ndërtimtarisë	2
	Të tjera : sistem ngrohje, ajrosje, klimatizimi, produkte të deterxhentave,lodra.	5
Shërbime	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	1
	Ngritjen e kapaciteteve prodhuese në lëmin e teknologjisë informative dhe telekomunikacionit në partneritet me kompaninë gjermane Muehlbauer.	1
Tregti	Shitja e pajisjeve për bebe si dhe kozmetikë për të rritur.	1
	Shitja e pajisjeve për furnizim me energji ne telekomunikacion dhe IT.	1
	Total bizneset	41

Tab. 1.2 Numri i të punësuarve sipas gjinisë në Parkun e Biznesit në Drenas

Numri i të punësuarve	Meshkuj	Gra
388	281	107

¹⁰ Të dhënat statistikore të të punësuarve të pranuar nga Komuna Drenas/12 Dhjetor 2019

3.3.2 Raporti ndërmjet Komunës së Drenasit dhe Zonës Ekonomike “Parku i Biznesit”

Marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe rezultatet e takimeve të realizuara me Komunën e Drenasit, mund të konstatojmë se Komuna e Drenasit ka rol të rëndësishëm në mbështetjen e bizneseve të zonës ekonomike “Parku i Biznesit”.

Mbështetjen ndaj zonës dhe bizneseve, Komuna e realizon përmes: ofrimit të kushteve infrastrukturore, qasjen në shërbimet publike (ujë, kanalizim, mbeturina), lehtësirat në taksa, prona komunale, alokimin e kërkesave, si dhe ofrimin e mbështetjes dhe bashkëpunimit. Të gjitha kërkesat, nevojat si dhe informacionet nga vet bizneset mirën drejtpërdrejtë në Komunë përmes Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik. Ndërkaq Komuna e Drenasit përfiton 70 për qind të hyrave nga qiraja nga Parku i Biznesit në Drenas, ndërsa 30 për qind i takojnë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për kryerjen e shpenzimeve komunali, të cilat mjete fillimisht derdhen në konton e MTI-së. Një rol të rëndësishëm ka edhe AZHR Qendër - Agjensioni për Zhvillim Rajonal, i cili në bashkëpunim me Komunën realizon gjitha sesionet informuese ndaj bizneseve, për sa i përket thirrjeve për grante të lansuara nga Ministritë, organizatat e huaja.

Aplikimi i bizneseve për të qenë pjesë e Zonave Ekonomike realizohet përmes thirrjes publike që realizon Komuna ku bizneset duhet të përmbushin gjitha kriteret e kërkuara dhe udhëzimet e konkurrimit të hapur. Komuna Drenas nuk e ka të themeluar në kuadër të sajë Qendrën e biznesit siç e kanë disa Komuna tjera prandaj bizneset qasen drejtpërdrejtë. Caktimi i çmimit për kompensimin e tokës ndërtimore është i rregulluar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Nenin 17 dhe 40 si dhe nenin 37,4 dhe 37,5 ne neni 94 të Statutit të Komunës. Ky çmim është 1€ për m² dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të mjedisit është zbatuese e këtij Vendimi në kuadër të Komunës. Tarifat, gjobat ngarkesat për shërbimet dhe veprimtaritë komunale janë të rregulluara me Rregullore dhe Dispozita të përgjithshme ku jo çdo biznes tatohet sipas veprimtarisë si dhe vet vlera monetare ndryshon varësisht veprimtarisë biznesore. Me rritjen e numrit të kërkesave të bizneseve për të kaluar në Zona Ekonomike është shfaqur nevoja e themelimit të një Zone të dytë e cila nga Komuna e Drenasit është paraparë të investohet përball Zonës së parë. Procesi është duke kaluar fazën e vizibilitetit dhe BERZH ka ndarë 17 milion Euro deri më tani për të investuar Zonën e Re (2). Ligji i ri për funksionimin e Zonave Ekonomike pritet të hyjë në zbatim, i cili përveç tjerash mundëson që shumë prona të AKP-së të kthehen në prona Komunale

3.3.3 Realizimi i vizitave nga MZHR në Zonën Ekonomike “Parku i Biznesit – Drenas”

Në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me MTI-në, me datë 02.09.2019 MZHR realizoj vizitën e parë në Zonën Ekonomike “Parku I Biznesit në Drenas”. Vizita u realizua nga një grup i përbashkët MZHR – MTI, ku u vizituan në përgjithësi një mostër prej 15 biznese apo 36 % e numrit të përgjithshëm prej 41 bizneseve që funksionojnë në kuadër të zonës ekonomike dhe që operojnë me profile të ndryshme biznesore. Temat e diskutuara ndërmjet ekipit ministror dhe përfaqësuesve të bizneseve, ndërlidheshin me kushtet e të bërit biznes brenda zonës, kapacitetet ekzistuese të bizneseve, evidentimi i nevojave për përkrahje institucionale, etj. Ndër të tjera, në kuadër të kësaj vizite u plotësuan 15 pyetësor me pyetje dhe përgjigje që ndërlidhen me fushën e të bërit biznes në kuadër të Z.E. Duke u bazuar në përgjigjet e marra nga bizneset në Parkun e Biznesit në Drenas, janë identifikuar edhe disa kompani të cilat

eksportojnë jashtë vendit si: (Gjermani, Belgjikë, Zvicër, Maqedoni, Shqipëri) si dhe kompani tjera që realizojnë eksport brenda vendit. Profilet e produkteve me të cilat realizohet eksporti me jashtë më të shquara janë: **produktet e përpunimit të drurit, dritaret nga druri dhe alumini, prodhimi i ngjyrave, si dhe prodhimi i dyerve automatike**. Bizneset në përgjithësi në përgjigjet e tyre se sa janë të kënaqur me kushtet brenda Zonës Ekonomike ata kanë dhënë përgjigjës mjaft pozitive me kushtet infrastrukturore që ofron Parku Biznesit në Drenas për të ushtruar veprimtarinë e tyre biznesore. Numri më i madh i bizneseve me një përqindje prej 80% janë të përkushtuar në prodhim dhe të njëjtat kanë paraqitur nevoja për furnizim me pajisje teknologjike, në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre prodhuese edhe në zhvillimin e nën sektorëve tjerë. Nga pyetja e parashtruar se të njëjtat a kanë qenë përfituese të skemave të deritanishme, rezultati del se vetëm 10% e tyre kanë përfituar ndonjë grant apo financim të ndonjë projekti nga shteti, për zgjerim të biznesit dhe rritjen e kapacitetit prodhues. Në pyetjen e parashtruar se nëse bizneset e tyre në të ardhmen do të mund të përfitonin një grant apo financim të një projekti të tyre, të njëjtat a kanë kapacitete njerëzore për implementim dhe financiare për bashkëfinancim, rreth 95% e bizneseve janë përgjigjur pozitivisht duke pohuar se kanë kapacitete financiare stabile për bashkëfinancim të një projekti me shtetin dhe kapacitete njerëzore për implementim të suksesshëm të tij. Pyetjet dhe rezultate e pasqyruara, dalin nga pyetësorët e plotësuar me biznese të profileve të cilat do të paraqiten në tabelën në vijim nr. 1.3.

Tab.1.3 Paraqitja tabelare e bizneseve, veprimtaria dhe profilet nga vizitat e MZHR-së

Veprimtaria	Nr. I bizneseve
Prodhim	10
Tregti	4
Shërbime	1
Total	15

3.3.4 Ndërlidhja e veprimtarive biznesore të kësaj zone me programet e MZHR-së

MZHR, përmes programit që e implementon çdo vit “Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar“, financon dhe mbështet sektorin privat përmes dhënies së gratneve për start up dhe bizneset ekzistuese. Ky program, ka për qëllim avancimin e zhvillimit rajonal të balancuar në pesë rajonet zhvillimore në Kosovë. Përmes zhvillimit të ndërmarrësisë, PZHRB mbështet dhe përkrah bizneset e reja dhe ato me potencial në rritje, përkrah bizneset prodhuese që kontribuojnë në zëvendësimin e importit, gjenerimin e vendeve të reja të punës si dhe ndërmarrjet që operojnë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve si dhe në shërbimet komerciale, investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve apo makinerisë, linja të prodhimit, softuerë, trajnime të specializuara në lidhje me investimet e lartpërmendura si p.sh: për përdorim të pajisjeve apo teknologjisë së re.

Në bazë të analizimit të dhënave të marra nga vizitat në terren të realizuara nga ekipi i MZHR-së, takimet dhe të dhënat tjera shtesë të pranuar nga Komuna e Drenasit, del se numri më i madh i veprimtarive i takojnë sektorit të prodhimit me një numër prej (37) bizneseve. Nga ky numër biznesesh që operojnë në ZE mund të thuhet se është konstatuar një % e lartë e deklaramit të tyre për nevoja për të shtuar kapacitetet prodhuese, apo për të zgjeruar prodhimin,

në nën sektorët tjerë si dhe të njëjtit kanë potencuar pastaj se kjo ka ndikim në rritjen e madhe të gjasave pastaj për të rritur eksportin. Parku i biznesit në Drenas ka një potencial të madh të bizneseve dhe sektorëve të cilët kanë nevojë për të shtuar kapacitet e tyre prodhuese, rritjen e kapaciteteve humane, aftësimin e tyre si dhe avancimin e strukturës organizative në biznes. Gjithashtu duhet të ceket edhe krijimi i Zonës së re Ekonomike (2) e cila në një perspektivë të afërt do të mbështesë bizneset dhe veprimtaritë e tyre duke paraqit një tërësi të integruar me Parkun e Biznesit në Drenas.

Në këtë kontekst, secili biznes që është vizituar dhe me të cilin është plotësuar pyetësori, është deklaruar se në rast të pranimit të një grandi apo financimit të një projekti nga shteti, do të ishte në gjendje absolute që të rris numrin e të punësuarve. Marrë parasysh të dhënat e cekura më lartë dhe politikat aktuale të zhvilluara nga MZHR mbi bazën e mandatit ligjor që e ka, mund të rekomandohet që MZHR të zhvillojë politika dhe programe të reja në vitet në vijim për të mbështet bizneset që operojnë në këtë zonë ekonomike.

Rezultati i numrit të bizneseve të kësaj zone që mund të kualifikohen për përkrahje nga MZHR mbi bazën e mandatit dhe programeve të saj, është si vijon:

- **Të kualifikueshme:** tridhjetë e nëntë (39) biznese janë potenciale që të ndërlidhen me kriteret e mbështetjes financiare nga PZHRB.
- **Të pakualifikueshme:** dy (2) biznese me sektorët e tyre të tregtisë;

Total: dyzet e një (41) biznese aktive në Parkun e Biznesit në Drenas.

3.4.1 Parku i Biznesit në Mitrovicë

Themelimi i Parkut të biznesit në Mitrovicë është iniciuar me kërkesë të shoqatës së Biznesit në vitin 2001 për të nxit Komunën që të sigurojë një hapësirë për të mbështetur bizneset prodhuese si dhe për të realizuar veprimtarin e tyre. Në bazë të nevojës së paraqitur Kuvendi morri një Vendimin nr. 215/01¹¹ të dt. 21.05. 2002 për ndarjen e një lokacioni prej 3.5 hektarësh për themelimin e këtij Parku. Kuvendi i Komunës Mitrovicë në mbledhjen e mbajtur me datë 13.01.2006 pasi që shqyrtoi propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të tokës ndërtimore themeloj Parkun e Biznesit në Mitrovicë. Ky projekt u mundësua me mbështetjen financiare të MTI-së e cila ka ndihmuar parkun e biznesit në infrastrukturë me vlerën prej 150,000€, pastaj punët i vazhdoi AER-i me 380,000.00€ dhe me përkrahjen e zyrës së Unionit Evropian në Prishtinë u mundësua që projekti i PBM të bashkë financohet me Komunën e Mitrovicës me një grant në vlerë prej afro 336,167.70€. Kështu për aktivizimin e Parkut të Biznesit janë investuar: 866,167,70€. Në Parkun e Biznesit u ndanë sipas projektit 22 troje me një hapësirë prej 9.5 ari për secilin biznes. Gjithsejtë janë të vendosura 22 biznese dhe nuk ka hapësira të lira për vendosje të bizneseve të reja në këtë Park. Për vendosjen e bizneseve në këtë Park, Kuvendi ka përzgjedhur përfituesit/bizneset më të arsyeshëm për të ndërtuar objektet e tyre për aktivitetin e tyre biznesor të cilët gjithashtu kanë plotësuar gjitha kriteret e përcaktuara në Thirrjet Publike të Komunës Mitrovicë. Profilet e bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre janë të ndryshme si: përpunues të drurit, të metaleve, prodhues të dymit

11 Të dhënat e pranuar nga Komuna Mitrovicë, datë 7 Nëntor 2019

dhe dritareve, të xhamave, mermerit, të letrës, prodhues ushqimor, të tekstilit dhe grumbullues e përpunues të mbeturinave.

Bazuar në të dhënat zyrtare të marra nga AZHR Veri - Agjencia për Zhvillim Rajonal –Veri, si përfaqësuese e vetme e bizneseve në këtë Zonë Ekonomike shohim se edhe në këtë Zonë veprimtaria biznesore po’ashtu realizohet në tre kategori, (prodhim, shërbime dhe tregti), ku dallohet veprimtaria prodhuese me numrin më të madh të bizneseve që operojnë në sektorin e prodhuesve të metalit, llamarinë si dhe veprimtaria e shërbimeve pasqyrohet me sektorin e shtypit të letrës dhe ndërtimtarisë. Më detajisht, sektorët më të zhvilluar mund ti gjeni të shtjelluara në Tab.2.1, ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve në bazë të të dhënave të konfirmuara nga AZHR Veri, nga 22 biznese që operojnë në këtë park janë të punësuar gjithsejtë 299 punëtorë ku nga ky numër 113 janë meshkuj dhe 186 janë femra.

Tab. 2.1, Bizneset, veprimtaria dhe profilet në Parkun e Biznesit në Mitrovicë

Veprimtaria	Sektorët	Numri i bizneseve
Prodhim	Prodhues të produkteve të drurit	2
	Prodhues llamarine	3
	Prodhues metali	4
	Prodhues të roleteve, dyerve dhe dritareve	2
	Përpunues mermeri	1
	Prodhues tekstili	1
	Prodhues letre	1
	Të tjera :prodhues deterxhenti ,prodhues i interierit,termoizolim	4
Shërbime	Shtyp ,liferim	2
	Ndërtimtari	1
Tregti	Grumbullimi dhe riciklimi I metaleve	1
	Total bizneset	22

Tab. 2.2, Numri I të punësuarve sipas gjinisë në Parkun e Biznesit në Mitrovicë

Numri i të punësuarve	Meshkuj	Gra
299	113	186

3.4.2 Raporti ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Parkut të Biznesit në Mitrovicë

Në këtë Komunë nuk ka të themeluar Qendër për biznese dhe bizneset për nevojat tyre qasen tek Agjencia për Zhvillim Rajonal në Veri –AZHR Veri. Nga viti 2013¹² me vendim të Komunës së Mitrovicës, Agjencia për Zhvillim Rajonal Veri është përgjegjësi i vetëm për menaxhimin e përgjithshëm të Parkut. Bizneset kanë qasje direkt në rrugët kryesore të Parkut si dhe kanë kyçjen individuale në rrjetin kryesor të parkut me kanalizim, ujë, telefoni, internet, etj. AZHR Veri, ka rolin kryesor në fasilitimin dhe mbështetjen e bizneseve rreth informimit për thirrjet e ndryshme për Grante, mbështetje teknike në realizimin e projekt propozimeve,

¹² Të dhënat e pranuar nga Agjensioni për Zhvillim Rajonal –Veri/datë 07 Nëntor 2019

realizimin e trajnimeve për aftësim të kapaciteteve humane për të aplikuar për grante, etj. Komuna Mitrovicë mbështet AZHR-në Veri me vlerën prej 5000€ në vit, ndërsa Komunitet serbe mbështet AZHR-në në shumën prej 3000€ në vit. Një çështje që vlen të ceket dhe e cila ka dal nga takimi i mbajtur me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Mitrovicës Jugore, është çështja se në këtë Park bizneset prej vitit 2016 funksionojnë në baza vetanake, pa një kontratë të nënshkruar nga Komuna. Një gjendje e tillë ka ardh në bazë të asaj se kontrata 10 vjeçare e nënshkruar me Komunë ka përfunduar dhe nuk është vazhduar asnjëherë pas vitit 2016 për arsye të cilat mund të jenë politike apo neglizhence. Një situatë e tillë ka çuar deri në një problematikë ku bizneset kanë dhënë pronat me qira nga vet pronarët tek akterët tjerë dhe një veprim i tillë nuk është i lejuar me ligj. Përveç kësaj, janë potencuar edhe dobësitë/mungesat në komunikim ndërmjet bizneseve të kësaj zone me Komunën. Pra, në përgjithësi mund të konkludohet se ka ngecje të zhvillimit të raportit të mirë ndërmjet Komunës dhe zonës ekonomike.

3.4.3 Realizimi i vizitave nga MZHR në Parkun e biznesit në Mitrovicë

Vizita bashkëpunuese mes MTI-së dhe MZHR-së u realizua në Parkun e biznesit në Mitrovicë me datë 03 Shtator 2019. Gjatë kësaj vizite u vizitua një numër të konsiderueshëm i bizneseve që funksionojnë në kuadër të zonës dhe u diskutua lidhur me vështirësitë dhe mangësitë e funksionimit, si dhe identifikuan nevojat që kanë bizneset për përkrahje nga institucionet në të ardhmen. Me këtë rast nga gjithsejtë njëzet e dy (22) biznese të vizituara, u plotësuan 10 pyetësorë mostrativ apo 45% e numrit të përgjithshëm të bizneseve që funksionojnë në këtë Zonë. Bazuar në të dhënat e marra nga pyetësorët e realizuar gjatë vizitave në terren janë identifikuar tre (3) Kompani që ekportojnë jashtë vendit me **profilet e termoizolimit, riciklimit dhe shtypje të materialeve dhe dokumenteve**. Eksporti më së shumti realizohet në shtetet si: **(Zvicër, Maqedoni, Shqipëri, Slloveni, Itali, Kroaci)**, ndërsa gjashtë (7) kompani tregtojnë, realizojnë shërbime dhe eksportojnë brenda Kosovës prodhimet e tyre si: **prodhim i tullave, prodhim i ëmbëlsirave, ushqim (distribui), prodhim i qeseve të mbeturinave dhe qeseve të frizit, sanitari, dyer metalike**. Referuar përgjigjeve të pranuara nga bizneset, janë potencuar nevojat e tyre për ti mbështetur me paisje më të avancuara në funksion të zgjerimit të kapaciteteve prodhuese si dhe aftësimin e kapaciteteve humane me trajnim të avancuara dhe specifike brenda dhe jashtë vendit. Nga të dhënat e marra prej pyetësorëve, shumica e bizneseve nuk kanë aplikuar dhe nuk kanë marrë grante nga shteti. Mbi 70% e bizneseve kanë paraqit nevojën e një granti për ti mbështetur me pajisje teknologjike të reja dhe më të avansuara për të rrit kapacitetet e tyre prodhuese që do të ndikonte edhe në rritjen e numrit të punësuarve dhe zhvillimin e nën sektorëve tjerë. 100% e bizneseve kanë kapacitete financiare për bashkëfinancim dhe kjo mundëson qëndrueshmërinë e implemtimit të grantit. Sa i përket infrastrukturës dhe organizimit të profileve të bizneseve, bizneset nuk kanë qenë shumë të kënaqur sepse në këtë Zonë Ekonomike ka pas përzierje të sektorëve në lokacione të papërshtatshme dhe interferuese në veprimtaritë e ndërsjella. Bizneset të cilat kanë marrë pjesë në plotësimin e pyetësorëve dhe që kanë dhënë përgjigje ndaj MZHR-së, janë të profileve të paraqitura si në tabelën në vijim, nr. 23.

Tab 2.3 Paraqitja tabelore e bizneseve, veprimtaria dhe profilet nga vizitat e MZHR-së

Veprimtaria	Nr. I bizneseve
-------------	-----------------

Prodhim	5
Tregti	1
Shërbime	4
Total	10

3.4.4 Ndërlidhja e veprimtarive biznesore të kësaj zone me programet e MZHR-së

Parku i Biznesit në Mitrovicë karakterizohet me numrin më të madh të bizneseve që zhvillojnë veprimtarinë e prodhimit në një zone ekonomike, në raport me zonat tjera në Kosovë. Nga njëzet e dy (22) biznese në total tetëmbëdhjetë (18) biznese janë të sektorit të prodhimit të profileve të drurit, ëmbëlsirave, llamarinës, metalit, tekstilit, letrës, mermerit etj. Edhe në këtë zone, bizneset kanë paraqitur nevojat e tyre për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, avancimin e kapaciteteve humane dhe aftësimin tyre për një treg më të kualifikuar pune. Parku i Biznesit në Mitrovicë, po ‘ashtu ka edhe një numër të madh të kompanive që ofrojnë shërbime, gjë që bën që këto dy veprimtari të ndërlidhen direkt me kriteret dhe objektivat e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar që zbaton dhe monitoron MZHR çdo vit për të mbështet sektorin privat. Ky program nuk kualifikon bizneset dhe sektorët që mirën me tregti me (pakicë dhe shumicë), ndërtimtarinë, bujqësinë duke përfshirë edhe pajisjet apo aktivitetet që ndërlidhen me fushë veprimtarinë e bujqësisë që financohen nga MBPZHR dhe sektorin e shëndetësisë. Nisur nga ky fakt shohim se në Parkun e Biznesit në Mitrovicë kemi një numër të vogël të bizneseve që mirën me tregti dhe asnjë biznes që në profilin e tij zhvillon sektorin e bujqësisë dhe shëndetësisë. Si përfundim, mund të konkludojmë se edhe kjo zone ekonomike mund të bëjë pjesë në ndonjë program apo politikë e zhvilluar nga MZHR në vitet në vijim, për përkrahje të bizneseve që operojnë në kuadër të zonave ekonomike.

Rezultati i numrit të bizneseve të kësaj zone që mund të kualifikohen për përkrahje nga MZHR mbi bazën e mandatit dhe programeve të saj, është si vijon:

- **Të kualifikueshme:** njëzet e një biznese (21) janë potenciale që të ndërlidhen me kriteret e mbështetjes financiare nga PZHRB.
- **Të pakualifikueshme:** një (1) biznes me sektorët e tyre të tregtisë;

Total: njëzet e dy (22) biznese aktive në Parkun Industrial në Mitrovicë.

3.5.1 Parku Teknologjik në Shtime

Parku Teknologjik në Shtime funksionon në kuadër të Komunës së Shtimes në një sipërfaqe prej 10¹³.70 ha. Kjo është një pronë komunale që i takon Komunës së Shtimes dhe ka marrë pëlqimin për themelimin e sajë nga MTI me datë 03.12. 2013. Ky park gjendet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime-Ferizaj (M-25.3). Parku Teknologjik gjendet afër qytetit, pranë magjistrals si dhe në udhëkryq në mes të Shkupit - Prishtinës dhe Tiranës me një infrastrukturë fizike të rregulluar (rrugë, ujësjellës, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, trotuare dhe ndriçim). Janë të vendosura (11) njëmbëdhjetë biznese të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznesore. Bazuar në të dhënat e marra nga Komuna Shtime përkatësit Drejtoria për Zhvillim Ekonomik bizneset paguajnë 10 euro qira vjetore për ari, ku 6 prej tyre kanë filluar veprimtarin, 5 janë në fazën e investimeve kapitale. Vendosja e bizneseve në këtë

park bëhet me thirrje publike, dhe thirrja publike realizohet sipas udhëzuesit administrativ për Zona Ekonomike. Parku Teknologjik në Shtime nuk ka më hapësira të lira për të pranuar biznese të reja meqenëse hapësira e paraparë nga Komuna është plotësuar tërësisht me biznese. Bazuar në të dhënat zyrtare të pranuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik të Komunës Shtime veçohen më shumë veprimtaritë e prodhimit të metalit, telit, betonit, prodhimet e drurit me një numër të përgjithshëm prej shtatë (7) bizneseve. Gjithashtu veprimtaria e tregtisë është e përfaqësuar me një numër prej katër (4) bizneseve që operojnë me sektorët e tyre. Më detajisht për sektorët referohuni tabelës Nr.3.2. Në Parkun teknologjik në Shtime janë të punësuar gjithsejtë 134 persona, ku nga ky numër 93 persona i takojnë gjinisë mashkullore dhe 41 persona i takojnë gjinisë femërore.

Tab.3.1, Bizneset, veprimtaria dhe profilet në Parkun Teknologjik në Shtime¹⁴

Veprimtaria	Sektorët	Numri i bizneseve
	Prodhues teli, metali	2
	Prodhues i pllakave nga kuarci dhe mermeri	1
	Prodhimi dhe përpunimi i rrëshirave epkside	1
	Përpunimin e metaleve, prodhimin e produkteve të betonit	1
	Prodhimin e kuzhinave	1
	Përpunimi i xhamave të ndryshëm	1
Tregti	Paketimi dhe distribuimi i produkteve për higjiena	1
	Konservimi i perimeve	1
	Grumbullimin, trajtimin e frutave dhe perimeve	1
	Zdrukhëtari metal punues	1
Shërbime	/	/
Total bizneset		11

Tab.3.2, Numri i të punësuarve sipas gjinisë në Parkun Teknologjik në Shtime

Numri i të punësuarve	Meshkuj	Gra
134	93	41

3.5.2 Raporti ndërmjet Komunës së Shtimes dhe Parkut Teknologjik në Shtime

Komuna e Shtimes përkatësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik është e vetmja pikë referuese për bizneset, nevojat, kërkesat dhe alokimin e ankesave të tyre. Komuna nuk ka të themeluar në kuadër të sajë një Qendër të bizneseve si pikë referimi për gjitha bizneset e cila do të funksiononte edhe në bashkëpunim me Komunën dhe do të plasonte çdo veprimtari, informacion përmes sajë. Po'ashtu një rol të rëndësishëm për sa i përket organizimit të

¹⁴ Të dhënat statistikore të pranuar nga Komuna Shtime/ datë 01 Nëntor 2019

sesioneve informuese, trajnimeve specifike, aftësimet për të aplikuar ne grante vendore apo organizata të huaja ka Agjencia për Zhvillim Rajonal Qendër, i cili funksionon ngushtë me Komunën dhe bizneset për tju ofruar mbështetjen e nevojshme teknike dhe administrative. Parku Teknologjik në Shtime ka një pozicion gjeografik shumë të favorshëm i cili ndikon në zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik. Ky Park gjendet 22 km larg autostradës Arbër Xhaferi dhe 10 km larg autostradës Ibrahim Rogova që ju mundëson bizneseve qasje mjaft të shpejtë edhe me vendet e rajoneve tjera. Gjithashtu Komuna Shtime në planifikimet e sajë strategjike për vitin 2020 do të krijoj një fond për përkrahjen e bizneseve të reja Start - upave.

Komuna është në procedurë të themelimit të Zonës Ekonomike dy (2) në¹⁵ fshatin Gllavic në hapësirën e përgjithshme prej 37 ha. Procesi është duke realizuar fazën e studimit të vizibilitetit dhe vlerësimit strategjik mjedisor si dhe çdo procedurë është në përputhje me planin Strategjik Komunal 2020-2030. Themelimi i një Zone të dyte ka ardh si pasojë e rritjes së numrit të kërkesave të bizneseve për të aplikuar në Zona Ekonomike duke potencuar kushtet dhe lehtësirat që ju ofrohen bizneseve për të realizuar veprimtarinë e tyre në mënyrë sa më të suksesshme dhe dinjitoze.

3.5.3 Realizimi i vizitave nga MZHR në Parkun Teknologjik në Shtime

Vizita në Parkun Teknologjik në Shtime u realizua me datë 04 Shtator 2019. Gjatë vizitës së realizuar në Parkun Teknologjik në Shtime nga 11 biznese të vendosura në Park janë realizuar katër (4) pyetësor mostrativ tek bizneset prezentë dhe aktive apo 36 % e numrit të përgjithshëm të bizneseve të vendosura në ZE në Shtime. Veçohet prodhimi si veprimtaria më e zhvilluar me profilet e prodhimit të shtyllave të betonit, shtyllave elektrike, përpunimi i xhamave dhe prodhimi nga druri dhe metali. Nuk ka asnjë biznes funksional që në profilin e tij të operimit ka shërbimet. Me veprimtarinë e tregtisë veçohen bizneset e sektorit të konservimit të perimeve, grumbullimin dhe trajtimin e frutave dhe perimeve si dhe zdrukthëtaria. Gjatë realizimit të intervistave me bizneset aktive që i kemi vizituar në terren dhe identifikimin e nevojave të bizneseve, më së shumti nga bizneset është potencuar mungesa e pajisjeve të teknologjisë më të avancuar në funksion të zgjerimit të prodhimit dhe vizionit për tu qasur në tregun ndërkombëtar me një infrastrukturë teknologjike më të avancuar. Gjithashtu është shprehur qartë nevoja për rritjen e aftësimit profesional të kapaciteteve humane të bizneseve për të gjeneruar punësim aktiv dhe më kualitativ. Infrastruktura e hasur në Parkun Teknologjik në Shtime është e mirë dhe e organizuar, si dhe bizneset janë mjaft të kënaqura në aspektin infrastrukturor dhe pozicionimit strategjik të lokacionit të Parkut.

Tab 3.3 Paraqitja tabelore e bizneseve, veprimtaria dhe profilet nga vizitat e MZHR-së

Veprimtaria	Nr. I bizneseve
Prodhim	3
Tregti	1
Shërbime	/
Total	4

15 Të dhënat e pranuar nga Komuna Shtime/01 Nëntor 2019

3.5.4 Ndërlidhja e veprimtarive biznesore të kësaj zone me programet e MZHR-së

Parku Teknologjik në Shtime ka numrin më të vogël të bizneseve që operojnë në krahasim me Parqet tjera të shtjelluara në këtë dokument. Gjithsejtë janë (11) njëmbëdhjetë biznese, ku nga ato shtatë (7) biznese mirën me veprimtarinë e prodhimit ndërsa (4) biznese tjera i takojnë veprimtarisë së tregtisë fushë jo e kualifikuar për tu mbështetur nga PZHRB. Gjithsesi prodhimi është sektor i cili ka një relevance të lartë në zhvillim ekonomik, punësim si dhe synon çdoherë rritjen e eksportit dhe zvogëlimin e importit nga vendet tjera. MZHR përmes PZHRB ka mbështet gjithmonë bizneset prodhuese me programet e sajë dhe synon edhe në të ardhmen të zhvillojë Programe dhe politika të njëjta zhvillimore dhe mbështetëse për bizneset që operojnë në Zona Ekonomik siç janë bizneset në Parkun Teknologjik në Shtime. Përfundimisht, edhe kjo zonë përmes bizneseve të saj, mund të konkurrojë për sigurimin e përkrahjes nga MZHR, në kuadër të ndonjë skeme apo programi të cilin do ta zhvillojë në të ardhmen për përkrahjen e tyre.

Rezultati i numrit të bizneseve të kësaj zone që mund të kualifikohen për përkrahje nga MZHR mbi bazën e mandatit dhe programeve të saj, është si vijon:

- **Të kualifikueshme:** njëzet e pesë biznese (7) janë potenciale që të ndërlidhen me kriteret e mbështetjes financiare nga PZHRB.
- **Të pakualifikueshme:** katër (4) biznese me sektorët e tyre të tregtisë;

Total: njëmbëdhjetë (11) biznese aktive në Parkun Teknologjik në Shtime.

3.6.1 Zona Industriale në Shirokë-Suharekë.

Zona Industriale në Suharekë, gjendet në fshatin Shirokë të Komunës së Suharekës, në lindje është e kufizuar me rrugën ekzistuese Suharekë – Prizren, në jug me rrugën ekzistuese të zonës së vjetër industriale, në perëndim me vreshtat ekzistuese dhe në veri me brezin e gjelbërimit. Themelimi i Zonës Industriale në Shirokë të Suharekës është bazuar në Vendimin 01¹⁶ Ref nr 116, të datës 03.03 2017 e marrë nga Kuvendi i Komunës në vitin 2006. Plani i hollësishëm rregullues për Zonën Industriale është marrë në vitin 2008. Vlerësimi i bizneseve në përmbushjen e kriterëve është realizuar përmes komisionit shtatë (7) anëtarësh me vendim të Kuvendit të Komunës ndërsa licencimi i zonës industriale është bërë në vitin 2016-2017. Veprimtaritë e vendosura në këtë zonë industriale janë: **përpunimi i produkteve ushqimore, përpunimi i prodhimeve nga tekstili dhe lëkura, përpunimi i elementeve nga materiali i aluminit, plastikës dhe drurit, përpunimi nga qelqi, guri, mermerin dhe hekuri elemente nga betoni, përpunimi i elementeve/teknikes nga elektrikë dhe elektroteknika**, etj. Gjithsejtë operojnë 29 biznese me veprimtaritë dhe profilet e tyre të ndryshme biznesore. Nga të dhënat zyrtare të pranuar nga Komuna Suharekë shohim se veprimtaria e prodhimit është një ndër veprimtaritë që ka numrin më të madh të bizneseve me një numër prej njëzet e një (21) bizneseve dhe profileve që operojnë në prodhim, duke vijuar me sektorin e shërbimeve në të cilin merren katër (4) biznese, si dhe tregtinë me tre (3) biznese. Më detajisht referohuni tabelës së mëposhtme Tab.4.1. Në Zonën Industriale në Shirokë të Suharekës janë të punësuar 715 punëtor ku nga ky numër 482 janë të gjinisë mashkullore dhe 233 janë të gjinisë femërore.

¹⁶ Të dhënat e pranuar nga Komuna Suharekë /12 Nëntor 2019

Tab.4.1 Bizneset, veprimtaria dhe profilet në Parkun e Biznesit në Zonën Industriale në Suharekë¹⁷

Veprimtaria	Sektorët	Numri i bizneseve
Prodhim	Prodhimi i shiringave	1
	Prodhime të metalit	2
	Prodhim i pajisjeve ftohëse	2
	Prodhim i shportave plastike	1
	Prodhim i pijeve jo alkoolike	1
	Përpunim & prodhim i rrushit	1
	Përpunimi i produkteve bujqësore	1
	Prodhim i këpucëve	1
	Prodhim nga plastika & alumini	1
	Prodhim i mobileve	2
	Prodhim i fasadave	3
	Përpunim i mermerit, gurëthyes	1
	Prodhim i elementeve të betonit	2
	Prodhim dyer, dritare, parket	1
	Prodhimi i zhiletëve të ndërtimtarisë	1
Shërbime	Çerdhe për fëmijë	1
	Ngrohje dhe klimatizim	1
	Shpërndarja e gasit dhe dioksidit të karbonit	1
Tregti	Grumbullim pemë & perime	1
	Depo e pijeve	1
	Depo të materialeve	1
	Deponi e derivateve	2
	Total bizneset	29

Tab. 4.2, Numri i të punësuarve sipas gjinisë në Parkun Teknologjik në Suharekë¹⁸

Numri i të punësuarve	Meshkuj	Gra
715	482	233

3.6.2 Raporti ndërmjet Komunës së Suharekës dhe Zonës Industriale në Shirokë të Suharekës

Për dallim nga komunat tjera, Komuna e Suharekës e ka të themeluar Qendrën e Bizneseve e cila fillimisht ka filluar si iniciativë e vet bizneseve ku ka kaluar në statutin e Qendrës dhe ka rolin kryesor si pikë e parë referuese për gjitha bizneset. Qendra e bizneseve funksionon në

¹⁷ Të dhënat statistikore të pranuar nga Komuna Suharekë/ 12 Nëntor 2019

¹⁸ Të dhënat statistikore të pranuar nga Komuna Suharekë / 12 Nëntor 2019

kuadër të Komunës së Suharekës. Bizneset anëtarësohen dhe paguajnë një shumë simbolike për anëtarësimin e tyre në këtë Qendër varësisht madhësisë së bizneseve. Bizneset e mëdha paguajnë vlerën 180€ në vit, bizneset e mesme 120€ në vit ndërsa bizneset e vogla 60€ në vit. Qendra e biznesit funksionon ngushtë me Komunën e Suharekës dhe luan një rol shumë efikas në alokimin e aplikimeve të bizneseve në procedurën zyrtare të hapur përmes Thirrjes që publikon Komuna zyrtarisht. Bizneset mund të marrin gjithë e informacionin e nevojshëm sa i përket kompetencave komunale, alokimit të kërkesave dhe ankesave të bizneseve, thirrjeve për aplikim për grante etj. Gjithashtu kjo qendër funksion ngushtë edhe me Agjencinë për Zhvillim Rajonal – AZHR Jug ku bizneset ftohen të marrin pjesë në sesione të ndryshme relevante, trajnime për ngritjen e kapaciteteve në të aplikuarit për grante të ndryshme qeveritare, organizatat e huaja dhe vendore si dhe ngritje profesionale të stafit. Tarifatat, gjobat dhe ngarkesat tjera tarifoje janë të rregulluara me rregulloren dhe dispozitat e përgjithshme të miratuara nga Komuna e Suharekës, ku vlerat tarifoje variojnë varësisht nga veprimtaria biznesore. Çmimi për m² është 0, 5ce¹⁹nt. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - MTI ka të themeluar Bordin me secilën Komunë dhe Komunitet përfaqësohen nga Kryetaret e Komunave.

3.6.3 Realizimi i vizitave nga MZHR në Zonën Industriale në Shirokë të Suharekës

Në vazhden e vizitave të planifikuara dhe bashkërenduara me MTI-në, MZHR ka realizuar me datë 05 Shtator 2019, vizitën në pesëmbëdhjetë biznese mostrative apo 51.7 % e numrit të përgjithshëm të bizneseve të vendosura në këtë Zonë. Në kuadër të kësaj zone, ishte një numër i konsiderueshëm i bizneseve funksionale ku u diskutua në përgjithësi lidhur me vështirësitë dhe mangësitë e funksionimit të tyre në kuadër të zonës, si dhe nevojat që kanë bizneset për përkrahje nga institucionet në të ardhmen. Nga bizneset e vizituara janë plotësuar gjithsejtë 15 pyetësor mostrativ në këtë Zonë. Gjatë procesit të intervistimit të bizneseve të kësaj zone, kuptuam se: (9) nëntë Kompani realizojnë veprimtarinë e tyre në prodhim ku nga ky numër, shtatë (7) kompani eksportojnë jashtë vendit (Zvicër, Gjermani, Itali, Maqedoni, Mali Zi, Shqipëri, Serbi), me veprimtaritë: **enterier i brendshëm, përpunim i lëndëve djegëse, prodhim i rrjetave të betonit, llaqeve, fasadës, polisterolit, dritare, roleta alumini dhe ngjyrave**. Dy (2) kompani importojnë në (Shqipëri, Maqedoni, Gjermani), veprimtaria e tyre është: **tregti e lëndëve djegëse-gazit, laminat dhe parket** dhe gjashtë (6) kompani eksportojnë produkte **brenda vendit, veprimtaria e tyre është: prodhim i elementeve të betonit, prodhimi mobilie, fasadave, ngjyrave, roletave të aluminit dhe gurit dekorativ**. Zona Industriale në Shirokë të Suharekës ka një infrastrukturë ende të papërfunduar me rrugë ende të pa shtruar dhe të papërfunduara gjë që është shprehur edhe me pakënaqësinë e bizneseve gjatë vizitës së realizuar nga MZHR. Shumica e bizneseve të intervistuar nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të granteve qeveritare dhe nuk kanë pas asnjë informacion për Skemën e Granteve që zhvillon MZHR-ja. 80% e bizneseve kanë shfaq nevojën e tyre për avancim në pajisje të teknologjisë më të re për të zgjeruar prodhimin, zëvendësimin e importit me eksport si dhe zhvillimin e nën sektorëve tjerë. Në vlerë prej 100% e bizneseve kanë kapacitetet e mjaftueshme financiare për bashkëfinancim që ndikon drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e implementimit të grantit.

¹⁹ Të dhënat e pranuar nga Komuna Suharekë /12 Nëntor 2019

Tab 4.3 Paraqitja tabelore e bizneseve, veprimtaria dhe profilet nga vizitat e MZHR-së

Veprimtaria	Nr. I bizneseve
Prodhim	9
Tregti	4
Shërbime	2
Total	15

3.6.4 Ndërlidhja e veprimtarive biznesore të kësaj zone me programet e MZHR-së

Zona Industriale në Shirokë të Suharekës është një ndër zonat që ka numrin më të madh të bizneseve me një numër prej njëzet (20) bizneseve që operojnë me veprimtarinë e prodhimit me profile të ndryshme prodhuese si: **dyer, dritare, prodhime të metalit, plastikës, drurit, plastikes, aluminit, metalit** etj. Duke marrë për bazë % e përgjigjeve të bizneseve të ofruara dhe pasqyruara në kapitullin e mëhershëm, lidhur me nevojat e tyre për përkrahje dhe marrë parasysh rolin që ka PZHRB në përkrahje të sektorit privat, përkrahja e kësaj zone do të kishte ndikim të mirë në punësim, në rritjen e kapaciteteve të tyre të prodhimit, si dhe në zgjerimin e sektorëve të ri. Si përfundim, në këtë zone, numri bizneseve të kalifikueshme dhe pakualifikishme për tu përkrahur nga MZHR, sipas mandatit dhe programeve aktuale, është si vijon:

Rezultati i numrit të bizneseve të kësaj zone që mund të kualifikohen për përkrahje nga MZHR mbi bazën e mandatit dhe programeve të saj, është si vijon:

- **Të pakualifikishme:** katër (4) biznese me sektorët e tyre të tregtisë;
- **Të kualifikueshme:** njëzet e pesë biznese (25) janë potenciale që të ndërlidhen me kriteret e mbështetjes financiare nga PZHRB.

Total: njëzet e nëntë (29) biznese aktive në Zonën Ekonomike në Shirokë të Suharekës.

IV. Përmbajtja e pyetësorëve të hartuar nga MZHR

Bashkë me Planin për realizimin e vizitave në zona ekonomike, Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale, ka hartuar pyetësorin për mbledhjen e të dhënave nga bizneset që funksionojnë në zona ekonomike.

Pyetësori, është hartuar mbi bazën e një metodologjie, duke marrë në konsideratë: Mandatin e MZHR-së për përkrahje të zonave ekonomike, Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, legjislacionin në fuqi, si dhe interesin e MZHR-së për identifikimin e nevojave të këtyre bizneseve për përkrahje. Qëllimi përfundimtar, ka qenë grumbullimi i të dhënave për krijimin e një pasqyrimi se në qfarë gjendje janë bizneset në kuadër të zonave ekonomike, si dhe sigurimin e burimeve të informacionit të cilat do të shërbenin për MZHR-në në rast se vendos të hartojë një politikë të përkrahjes së tyre.

Pyetësori ka përmbajtur dhjetë (10) pyetje me përgjigje të shumëfishta, të cilin po e paraqesim për ilustrim në kuadër të kësaj analize.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

PYETËSOR: Funksionimi i bizneseve në zona ekonomike

Emri i të intervistuarit: _____

Emri i biznesit: _____

Vendndodhja/Zona ekonomike _____

1. Pozicioni i të intervistuarit:

- ☐ Pronar/Aksionar
☐ Drejtor/Drejtor Ekzekutiv
☐ Menaxher i përgjithshëm
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni pozicionin tuaj _____

2. Sektori në të cilën vepron kryesisht firma juaj:

- ☐ Prodhim/çka _____
☐ Tregti/çka _____
☐ Shërbim/çka; _____
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

3. Madhësia e firmës suaj:

- ☐ Minimale, me numër të punëtorëve rreth _____;
☐ Biznes i vogël, me numër të punëtorëve rreth _____;
☐ Biznes i mesëm, me numër të punëtorëve rreth _____;
☐ Biznes i madh, me numër të punëtorëve rreth _____;
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

4. Që sa vite funksionon biznesi Juaj?

- ☐ 0-2 vite;
☐ 2 apo më shumë vite;
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

5. Aktualisht, çka ju mungon juve për të pasur sukses në biznes?

- ☐ mungesa e vizionit dhe misionit,
☐ mungesa e menaxhimit strategjik,
☐ mungesa e investimeve,
☐ mungesa e inovacionit,
☐ mungesa e përvojës,
☐ mungesa e hulumtimit të marketingut,
☐ mungesa e njohurive rreth nevojave të konsumatorit,
☐ mungesa e teknologjisë/pajisjeve
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

6. Sa jeni të kënaqur me kushtet të cilat i keni brenda zonës ekonomike?

- ☐ I kënaqur;
☐ I pa kënaqur sepse mungojnë _____;
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

7. A keni qenë ndonjëherë përfitues i ndonjë grandi nga shteti?

- ☐ Po, viti _____;
☐ JO;
☐ Nuk kam aplikuar
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

8. A keni dëgjuar për Skemën e Granteve për Biznese e cila aplikohet nga MZHR dhe a keni aplikuar?

- ☐ Po, kam dëgjuar dhe kam aplikuar;
☐ Po, kam dëgjuar dhe nuk kam aplikuar;
☐ Jo, nuk kam dëgjuar;
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

9. Në rast se do të përfitonit grand nga institucionet, çka do të Ju ndihmonte në funksionim të biznesit?

- ☐ Zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, shërbuese, etj;
☐ Rritjen e numrit të punëtorëve/punësimin e punëtorëve të rinj;
☐ Zëvendësimin e importit dhe rritjen e eksportit;
☐ Tjetër, Ju lutem specifikoni _____

10. Cilat janë kapacitetet njerëzore dhe financiare të biznesit për implementim me sukses të një grandi?

- ☐ Biznesi ka kapacitete financiare për bashkëfinancim të një grandi dhe sigurimin e qëndrueshmërisë;
☐ Biznesi ka strukturën organizative dhe njerëzit adekuat në rolet menaxhuese dhe ekzekutuese;
☐ Biznesi është në rritje dhe nuk ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe njerëzore;

V. Përfundime dhe rekomandime

Krijimi i zonave ekonomike ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin ekonomik në vend, veçanërisht atë privat, të nxisë investimet, të hap vende të reja pune, të tërheq teknologjitë e përparuara, të rrisë konkurrencën e biznesit vendor, etj. Një impakt të tillë që kanë Zonat Ekonomike në zhvillim e përgjithshëm ekonomik të vendit bën që Ministria e Zhvillimit Rajonal duke u bazuar në mandatin e sajë të zhvillojë edhe politika dhe programe në funksion të mbështetjes së ZE-ve dhe zhvillimit të përgjithshëm rajonal të balancuar në pesë rajonet zhvillimore:(Qendër, Veri, Lindje, Jug dhe Perëndim).

MZHR zhvillon dhe implementon çdo vit “Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar” i cili Program përkrah bizneset e vogla dhe të mesme. Kjo Skemë ka për synim të përgjithshëm zhvillimin rajonal të balancuar në pesë rajonet zhvillimore në Kosovë përmes zhvillimit të ndërmarrësisë. Synon që projektet cilësore afariste të implementohen dhe zhvillohen më tejë, duke krijuar vende të lira të punës, të cilat do të gjenerohen me rritjen e ndërmarrjeve ekzistuese dhe sektorët e tyre që kanë potencial rritjeje.

Mbështetja e bizneseve që operojnë në Zona Ekonomike nga MZHR është qëllim strategjik të cilin MZHR synon ta realizojnë gjatë viteve në vijim duke konsideruar të hartojë një program i cili do të mbështesë vetëm bizneset që operojnë në Zona Ekonomike. Në funksion të hartimit të kriterëve të Thirrjes të cilët duhet të korrespondojnë me nevojat e bizneseve si dhe kriteret e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar të shtjelluar më lartë, DPASER - Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio - Ekonomike Rajonale në kuadër të MZHR-së ka hartuar dhe realizuar paraprakisht pyetësorët për të identifikuar nr. e sektorëve, profileve, nr. e të punësuarve, kapaciteteve humane dhe financiare si dhe identifikimin e nevojave të bizneseve për të zgjeruar veprimtarinë e tyre prodhuese dhe zgjerimin e biznesit. Nga të dhënat e marra përmes pyetësorëve nga bizneset dhe të dhënat nga Komunitat në kuadër të të cilave funksionojnë Zonat Ekonomike, arrijmë tek përfundimet si vijon:

- Shumica e profileve biznesore janë të përfshira në veprimtarinë e prodhimit dhe përpunimit me një numër të përgjithshëm prej (84) tetëdhjetë e katër bizneseve apo 81% e numrit të përgjithshëm të gjitha zonave.
- Profilet e prodhimit dhe përpunimit nga bizneset e vendosura në kuadër të zonave, janë: metali, drurit, dyerve, dritareve, plastikës, ëmbëlsirave, etj.
- Sektori i tregtisë pason si sektori i dytë me një numër prej njëmbëdhjetë (11) bizneseve apo 10.6 % në profilet: e grumbullimit, konservimit, depo riciklimit, shitje me shumicë dhe pakicë, etj.
- Sektori i shërbimeve, bën pjesë me një numër të përgjithshëm prej (8) tetë bizneseve apo 7.7 % e bizneseve në total në katër (4) zona, me profilet e: ndërtimit, shtypit të letrës, shërbimeve të instalimit të ngrohjes, funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të klimatizimit, etj.

Përfundimet e lartshënuara, ilustrohen në mënyrë më detaje në tabelat në vijim:

Tab 5.1 Tabela e të dhënave totale të profileve në katër Zonat Ekonomike

Veprimtaritë	Parku Biznesit Drenas	Parku Biznesit në Mitrovicë	Parku Teknologjik në Shtime	Zona Ekonomike në Shirokë të Suharekës	Totali sipas veprimtarive
Prodhim	37	18	7	22	84
Tregti	2	1	4	4	11
Shërbime	2	3	/	3	8
Total	41	22	11	29	103

Tab 5.2 Tabela e të dhënave totale të punësimit në baza gjinore

Zonat Ekonomike	Gra	Meshkuj	Total
Parku Biznesit Drenas	107	281	388
Parku Biznesit në Mitrovicë	186	113	299
Parku Teknologjik në Shtime	41	93	134
Zona Ekonomike në Shirokë të Suharekës	233	482	715
Totali	567	969	1536

Duke marrë parasysh të gjitha të cekurat më lartë, arrijmë tek rekomandimet si vijon:

- MZHR, të përgatis një skemë me përmbajtje të ngjashme sikurse ajo e viteve të kaluara, në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve.
- Marrë parasysh se 90% e bizneseve janë me mbi 2 vite funksionim dhe i përkasin kategorisë LOT – 3 dhe 10% kategorisë LOT - 2, programi të përmbaj një shumë të financimit për katër (4) zonat ekonomike ku funksionojnë biznese, rreth 500.000 (pesëqind mijë) euro.
- Programi duhet t'i dedikohet vetëm bizneseve që funksionojnë në kuadër të zonave, dhe të nxisë konkurrueshmerinë për zhvillim të mëtutjeshëm ndërmjet zonave.
- Në procesin e lansimit të Skemës, të përfshihen në cilësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit: MTI, Komunat ku funksionojnë zonat dhe AZHR-të.
- Skema e granteve, mund të publikohet në të njëjtën kohë me Skemën e granteve për biznese në të gjithë Kosovën.

VI. Burimet e shfrytëzuara:

- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8654> - Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 6/12 Mars 2013, Prishtinë - Ligji Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike.
- <https://kiesa.rks-gov.net/desk/inc/media/8B7B0232-0CD8-463F-AEF3-A71ECCDB69A9.pdf> - Rregullore nr.01/2013 për punën e Këshillit për Zonat Ekonomike
- <https://kiesa.rks-gov.net/> - Faqja zyrtare e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë
- <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,65>
- Të dhënat e pranuar nga MTI/datë 16 Dhjetor 2019
- Komentet e pranuar nga Komuna Drenas/ datë 13 Nëntor 2019
- Komentet e pranuar nga Komuna Mitrovicë/datë 07 Nëntor 2019
- Komentet e pranuar nga Komuna Shtime/datë 01 Nëntor 2019
- Komentet e pranuar nga Komuna Suharekë/datë 12 Nëntor 2019
- Të dhënat e pranuar nga Agjencia për Zhvillim Rajonal –Veri/datë 07 Nëntor 2019

